



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.347/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, të parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

- I. **PRANOHET E BAZUAR** ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, Anr.347/2025 datë 03.02.2025.
- II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 3,000.00€uro (tremijë) Euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.
- IV Urdhërohet kandidati i subjektit politik LVV Dimal Basha që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largoj nga rrjeti social facebook postimin me titull *OFERTA E 9 shkurtit e përmbledhur në një foto!* të datës 21.01.2025.

A r s y e t i m

Me datë 03.02.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën ka vërejtur se kandidati për deputet Dimal Basha ka postuar ne rrjetin social facebook një postim ku shprehimisht thotë: *OFERTA E 9 shkurtit e përmbledhur ne një foto!*. Dhe lider tjerash, ka bashkëngjitur një foto te ish-kryeministrit Hoti qe vjen nga radhët e LDK si dhe presidentit serb Aleksander Vuçiq. Me këtë rast i njëjti ka krahasuar subjektin politik LDK me një president serb, i cili në Kohen e Luftës ne Kosove ka qene Ministër i Informacionit në Qeverinë e Mirko Marjanovic dhe atë te kasapit te Ballkanit Sllobodan Millosheviq, gje e cila dihet botërisht (fakt notor). Prandaj, ky krahasim i deputetit Basha është gjuhe e nxitje e urrejtjes, provokim i skajshëm, Shkelje brutale dhe e rende e nenit

34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 të Ligjit për Zgjedhje e Përgjithshme, i cili shprehimisht thotë: 1.11. përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë. Per me tepër, ky krahasim i partisë me të vjetër në trojet mbare shqiptarë që është edhe barazim sipas fotos se bashkëngjitur me një ish-ministër që ka bërë thirrje për vrasje të shqiptareve në Kosovë është shkelja më e rëndë që mbahet mend në histori të shkeljeve të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, por që e njëjta e tejkalon edhe këtë limit.

Rast precedent e keni Vendimin që vet e keni nxjerr ju si PZAP, A.nr. 28/2025, cit. 15.012025 por që në asnjë rrethanë për nga provokimi e urrejtja nuk mund të krahasohet me krahasimin brutal të ulet, nënçmues, përbuzës që ka bërë kandidati për deputet Dimal Basha. Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkëngjitur si provë fotografinë e printuar nga rrjeti social i kandidatit për deputet LVV. Meqë i njëjti nuk e ka fshire ende postimin dhe po vijon me shkeljen përsëritëse, kërkojmë nga PZAP që në vendim gjobitesh të radhës ta sanksionoj të njëjtin si përsëritës veprë me gjobe me të larte sesa nga ajo paraprake, e vendimit të PZAP A.nr. 137/2025, date 24.01.2025. Andaj, duke u bazuar në gjithë këto që u thane me larte dhe provat e bashkëngjitura kërkojmë nga ana juaj si organ kompetent dhe i autorizuar që të merrni Vendim meritor për rastin në fjale, pra të shqiptoni mase sanksionuese ndaj subjektit politik LVV dhe kandidatit për deputet Dimal Basha.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 04.02.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), theksohet se nga pretendimet ankimore të ankuesit dhe foto dokumentacioni që ankuesi i ka bashkëngjitur ankesës fare lehtë mund të konstatohet se të njëjtën ankesë Paneli Zgjedhor Për Ankesa dhe Parashtrësia e ka shqyrtuar dhe ka marrë vendimin A.nr.137/2025 për shqiptimin e gjobës ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje. Andaj duke marrë për bazë rrethanat e lartcekura pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe argumenteve të parashtruara nga palët, i propozojmë PZAP-së që ta hedhë të palejuar ankesën.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se :

-Ankesa është e bazuar.

Paneli me vendimin e tij Anr 137/2025 të datës 24.01.2025 e ka Pranuar të bazuar ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, ndërsa politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i ka shqiptuar dënimin më gjobë në lartësi prej 10,000.00 (dhjetëmijë) Euro, dhe e ka detyruar të njëjtën që gjobën e shqiptuar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Ndaj vendimit të PZAP-it subjekti politik LVV ka parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme dhe e njëjta me Aktgjykimin AA 14/2025 të datës 31.01.2025 ankesën e subjektit politik LVV e ka refuzuar të pabazuar dhe ka vërtetuar vendimin e PZAP-it.

Po ashtu edhe subjekti politik LDK ka parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme dhe e njëjta me Aktvendimin AA 21/2025 të datës 01.02.2025 ankesën e subjektit politik LDK e ka hedhë të pasafatshme

Në ankesën e Anr. 347/2025 të datës 03.02.2025 subjekti politik LDK thekson se kandidati për deputet nga subjekti politik LVV Dimal Basha nuk e ka fshire ende postimin dhe po vijon me shkeljen përsëritëse në të cilin postim shprehimisht thotë se *“Oferta e 9 shkurtit e përmbledhur*

në një foto”, ku krahas këtij postimi ka bashkangjitur një foto të ish kryeministrit Hoti që vjen nga radhët e subjektit politik LDK si dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq.

Paneli, pas shikimit të bërë fotografisë së ofruar si provë materiale e cila është publikuar në rrjetin social të kandidatit për deputet të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) Dimal Basha, si dhe hetimet e bëra nga Paneli është vërtetuar se postimi në fjalë ende ekziston në rrjetin social të kandidatit Dimal Basha, prej nga rrjedh se ky postim ka për qëllim etiketimin e subjekteve tjera politike, dhe promovimit të subjektit politik LVV, e veçanërisht etiketimin, dhe krahasimin negativ të subjektit politik, në atë mënyrë që përmes rrjetit social ka publikuar foto, përkatësisht shpërndarjen në faqen e tij të rrjetit social foto, është bërë krahasimi i subjektit politik LDK me figurën e Aleksandër Vuçiqit.

Përdorimi i një fotografi të tillë të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se : *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërs si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.*

Paneli vlerëson se në rastin konkret kandidati, përkatësisht subjekti politik LVV përkundër vendimit të formës së prerë të PZAP-it A.nr.137/2025 datë 24.01.2025 nuk i është përmbajtur detyrimit që të largoj postimin nga rrjeti social facebook, andaj bazuar në këtë vendim të PZAPI-it, urdhërohet kandidati nga subjekti politik LVV Dimal Basha që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largoj postimin e publikuar nga rrjeti social facebook. Njëherit njoftohet subjekti politikë në fjalë se duhet të veprojnë sipas nenit 120, par.2 të LZP, ndërsa dështimi për t’iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

A.nr.347/2025 më datë 06.02.2025

**Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi**



KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa bazuar në nenin 118 paragrafi 4 të LZP-së.*